



**INFORMACION**

**KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**TIRANË**

Të nderuar zotërinj!

Në cilësinë e Ekspertes Kontabël të Regjistruar, bazuar në vendimin numër 969, dt.10.08.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe të kontratës të shërbimit lidhur me të me numër protokoli të sajën 7708, datë 29.09.2015, kam pasur detyrë të auditoj pasqyrat që lidhen me financimin e fondeve të përfuara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore për organet qeverisjes vendore, që filloi me datë 21.05.2015 me regjistrimin e partisë "Fronti i Majtë" në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (si subjekt zgjedhor) dhe u mbyll me datë 20.06.2015 me përfundimin e fushatës zgjedhore të 21 qershor të vitit 2015

Subjekti, partia "Fronti i Majtë", sipas regjistrimit të partive të vitit 2015, i cili na u dorëzua nga KQZ-ja bashkë me nënshkrimin e kontratës së mësipërme, ka të shpallur si nr kontakti telefoni numrin e celularit 0684715007, si person kontakti z. Fane Tarifa dhe si financier zj. Kludja Kaja. Në këtë numër telefoni, pavarësisht se numri është në shërbim, nuk është përgjigjur asnjëherë asnjë person. Në adresat e shënuara nuk u arrit të gjendej njeri.

**EKSPERTE KONTABËL E REGJISTRUAR  
FATMIRA KASTRATI (SYKJA)**

Tiranë, më 25 nëntor 2015



**EKR EKSPERTE KONTABËL E REGJISTRUAR  
FATMIRA KASTRATI (SYKJA)**

**NR LICENCE 14, datë 11/01/2000**

## **RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR**

**Për auditimin ligjor të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara**

**Partia “Fronti i Majtë”**

**Fushata zgjedhore 2015**

**Periudha 21/05/2015 - 20/06/2015**



**RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR**

**KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**TIRANË**

Të nderuar zotërinj!

Në cilësinë e Ekspertes Kontabël të Regjistruar, bazuar në vendimin numër 969, dt.10.08.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe të kontratës të shërbimit lidhur me të me numër protokoli të sajin 7708, datë 29.09.2015, kam audituar pasqyrat që lidhen me financimin e fondeve të përfuara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore për organet qeverisjes vendore, që fillon me datë 21.05.2015 me regjistrimin e partisë "Fronti i Majtë" në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (si subjekt zgjedhor) dhe mbyllet me datë 20.06.2015 me përfundimin e fushatës zgjedhore të 21 qershor të vitit 2015.

Përgatitja e këtyre pasqyrave është përgjegjësi e drejtuesve të partisë "Fronti i Majtë". Detyra e subjektit zgjedhor është të përgatisë pasqyrat mbi bazën e arkëtimit dhe pagesave.

Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin e kryer. Auditimi u krye në zbatim të kërkesave të Standarteve Ndërkombetare të Auditimit, në referencë të veçantë me SNA-në 800: "Auditimet e pasqyrave financiare të përgatitura sipas kuadrove për qëllime specifike".

Këto standarte kërkojnë që unë të planifikoj dhe të kryej auditimin për të zotëruar siguri të arsyeshme se këto pasqyra nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare që përfshijnë: librin e llogarive të subjektit, regjistrin e posaçëm të miratuar si model me vendim nr.266 të KQZ-së, dt.01.06.2009 si dhe pasqyrën e arketim pagesave. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Në pamundësi të krijimit të lidhjeve me përfaqësuesit e partisë "Fronti i Majtë", e si rrjedhojë dhe sigurimin e evidencës së nevojshme, nuk mund të shpreh asnjë opinion.

Bashkëlidhur dokumentet përkatëse.

**EKSPERTE KONTABËL E REGJISTRUAR  
FATMIRA KASTRATI (SYKJA)**

Tiranë, më 25 nëntor 2015



**EKR EKSPERTE KONTABËL E REGJISTRUAR  
FATMIRA KASTRATI (SYKJA)**

**NR LICENCE 14, datë 11/01/2000**